



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE



Prenull - Përmirësimi: 08.10.2021			
Nr. origjinali broj Origjinali	Numri-Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
05-384/21			

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti-na

Në bazë të Rregullorës për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Vitisë nr. 01-013/246 neni 3,6,8,9 dhe neni 10,si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim. Drejtoria e Arsimit e Komunës së Vitisë shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Vitisë,për vitin akademik 2021/22

Drejtoria e Arsimit të Komunës së Vitisë shpallë konkurs publik për ndarjen e 130 bursave për student, të vitit akademik 2021/22. Prioritet do të kenë fakultetet-drejtime deficitare.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë student banorë të Komunës së Vitisë,
- Të jenë student të rregullt në Universitetin Publik të Republikës së Kosovës,
- Drejtimet deficitare i përcakton Komisioni i ndarjes (vlerësimit) sipas Rregullorës Nr.01-013/246 të Kuvendit Komunal të Vitisë,për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë.

Në kushte të barabarta ,përparësi në përfitimin e bursës kanë:

- Studentët me asistencë sociale,
- Studentët e veteranëve të Luftës,
- Studentët e familjeve të dëshmorëve,invalidëve të Luftës,
- Studentët e gjinisë femërore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Për studentët fillestar diploma e shkollës së Mesme, ID kartela e fakultetit fotokopje.
- Studentët të cilët kanë përfunduar ndonjë vit akademik të sjellin çertifikatën e notave (ID kartela fotokopje).
- Vërtetimi i semestrit të vitit akademik 2021/22

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtorin komunale të Arsimit në Viti. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik,ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim.

Më : 08.10.2021.Viti

